



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ prot.

Datë ____/____/ 2018

V E N D I M

Nr. 75 , Datë 19 / 03 / 2018

K O N S T A T O I :

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me Nr. Regj. 58, datë 25.06.2014, të paraqitur nga shtetësja A. B, kundër Qendrës së Formimit Policor, Sauk, Tiranë, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “*predispozicionit gjenetik*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Znj. B ka fituar dy herë konkurimin për Shkollën Bazë të Policisë me rezultate shumë të mira. Komisioni Shëndetësor i ka hequr të drejtën për të vazhduar më tutje, me argumentimin se ajo nuk kishte paraqitur të bukur për të qenë pjesë e Policisë së Shtetit. Analizat dhe kontrollet e kërkuara mjeko-ligjore i ka patur me rezultatin “shumë mirë”. Por, ankuesja thekson faktin se ajo ka disa quka të trashëguara që nuk paraqesin ndonjë problem, referuar edhe Vertetimit të lëshuar nga Mjeku Specialist Dermatolog. Përrjashtimi për këtë fakt, bën që ajo të ndjehet e diskriminuar dhe e refuzuar pa të drejtë, sipas pretendimit të saj në heqjen e mundësisë për të vazhduar më tutje shkollimine saj në Shkollën Bazë të Policisë.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri që t’i jepet e drejta për të qenë e barabartë dhe për të vazhduar studimet në Shkollën Bazë të Policisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, *racën*, ngjyrën,

etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së¹, në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.623/2 prot, datë 03.07.2014 të Komisionerit i është kërkuar informacion Departamentit për Trajnimin Policor, Qendrës së Formimit Policor, Sauk, Tiranë, lidhur me pretendimin e znj.B.

Me anë të shkresës me nr. 1148/1 Prot., datë 14.07.2014, Qendra e Formimit Policor, bën me dije se procedura për pranimin në Shkollën Bazë të Policisë bëhet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe se në Qendrën e Formimit Policor bëhet shkollimi i punonjësve të policisë për “Patrullë e Përgjithshme”.

2. Me datë 24.09.2014, në zbatim të Urdhërit nr. 127, datë 19.09.2014, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, realizoi një inspektim në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në lidhje me shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së znj. B, si dhe për të kryer verifikimet e nevojshme. Nga takimi me z. A. F, me detyrë Shef i Sektorit të Trajnimit, pranë kësaj Drejtorie, na u bë me dije se praktika me kërkesat e Komisionerit ende nuk i është deleguar zyrës së tij dhe me t’iu ngarkuar nga Drejtori i

¹ Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, z. D, ai do e përgatiste dhe do të na dërgonte përgjigje zyrtare.²

Me shkresën me nr. 1053/6 Prot., datë 30.09.2014, nga ana e Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, bëhet me dije procedura e ndjekur prej tyre lidhur me znj. B, ku sqarohet se; në zbatim të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, me nr. 872, datë 06.06.2014, për “Krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Aftësive Shëndetësore, marrjen e gjurmëve të gishtave, marrjen e masave trupore të uniformave për aplikantët që vazhdojnë konkurrimin për në Shkollën Bazë të Policisë “Patrullë e Përgjithshme”, u krijua Komisioni për Vlerësimin e Aftësive Shëndetësore pranë Sektorit të Profilaksisë dhe Mjekimit.

Me datë 10.06.2014, znj. B ka marrë pjesë në fazën e Vlerësimit të Aftësive Shëndetësore, prej ku rezultoi “ E pa aftë”, për arsye se në lëkurë ka pigmente tëgjeneralizuara. Në bazë të nenit 24, pika ç) e Rregullores së Personelit të Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 804, datë 21.11.2007, dhe procedurave standarde të Burimeve Njerëzore, për aplikantët të cilët rezultojnë “të paaftë” gjatë Kontrollit Mjekësor, skualifikohen menjëherë dhe nuk mund të bëhen pjesë e Shkollës Bazë “Patrullë e Përgjithshme”.

Me shkresën me nr. 1053/4-A, datë 16.07.2014,³ znj. B i është kthyer përgjigje në lidhje me pretendimet që ajo kishte mbi arsyet e skualifikimit të saj për të vazhduar këtë shkollë, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Në Dosjen personale të znj. B, pranëKomisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndodhet e depozituar korrespondenca e znj. B me z. K, Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.⁴

Ñ Me anë të shkresës me nr. 1053/A prot., datë 30.06.2014, znj. B i drejtohet z. K, në detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Burimeve Njerëzore. Ajo kërkon që dosja e saj të rishqyrtohet dhe t’i jepet një përgjigje zyrtare, pasi këtë vendim e konsideron të padrejtë, paragjykes e diskriminues përkundër saj.

Ñ Me datë 10.07.2014, ora 16:10 nga ana e z. K, i është kthyer përgjigje në adresën e e-mailit: ailda89@gmail.com, nga adresa zyrtare e Shkollës së Policisë: shkollaepolicise@asp.gov.al, ku i bëhen me dije arsyet se pse ajo ështëskualifikuar.

Ñ Në e-mailin e dërguar nga znj. B me datë 11.07.2014, ora 12:53, i kërkon z. K që t’i kthejë përgjigje në mënyrë shkresore.

Ñ Nga ana e z. K me anë të shkresës me nr. 1053/4A. Prot., datë 16.07.2014, znj. B i është kthyer e njëjta përgjigje si në e-mailin e datës 10.07.2014, por i është dërguar në mënyrë shkresore.

²Referuarthënievetë z. F, shënuarnëproces-verbalin e datës 24.09.2014.

³Shkresandodhet e depozituarnëDosjen me nr.58 Regj./2014, pranëKomisionerit.

⁴Këtu përfshihen kërkesat e ankueses dhe përgjigjet me e-mail dhe ato në mënyrë shkresore të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

№ Po kështu, nga verifikimi i Listës së aplikantëve pjesëmarrës në konkurrimin për Shkollën Bazë të Policisë “Patrullë e Përgjithshme”, për periudhën 09 Qershor – 08 Korrik 2014, lidhur me rezultatet e vlerësimit të aftësive shëndetësore, rezultojnë se nga 593 (pesëqind e nëntëdhjetë e tre) aplikantë gjithsej, 38 (tridhjetë e tre) prej tyre janë të “pa aftë”⁵, si rezultat i vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Aftësive Shëndetësore.

3. Me vendimin nr. 147, datë 24.09.2014, Komisioneri vendosi pezullimin e procedimit administrativ për ankesën në fjalë, pasi për verifikimin e fakteve të pretenduar nga subjekti ankues, u vlerësua e domosdoshme marrja e informacionit nga ana e Komisionit Shëndetësor, pranë Sektorit të Profilaksisë dhe Mjekimit.
4. Me shkresën me nr.10 prot., datë 09.09.2014, Komisioneri ka kërkuar informacion dhe vlerësimin e ekspertëve të PAMECA-s, lidhurme shpjegimet specifike për faktin se cilat do të konsiderohen si “çikatriçe”, “njolla” të dukshme në lëkurë.
5. Me shkresën me nr.623/6 prot., datë 30.10.2014 i është dërguar një kërkesë e dytë për informacion ekspertëve të PAMECA-s.

Theksojmë faktin se nga ana e ekspertëve të PAMECA-s nuk ka ardhur asnjë përgjigje lidhur me specifikimet, për të cilat Komisioneri kishte kërkuar opinion dhe asistencë profesionale.

6. Në përmbushje të sa më sipër, si dhe në vijim të zbatimit të Urdhërit të inspektimit nr. 127, datë 19.09.2014, inspektorët e Komisionerit, me datë 08.10.2014, u takuan me z. E. Sh, me detyrë Shef i Sektorit të Profilaksisë dhe Mjekimit. Meqenëse, nuk ishte e mundur teknikisht⁶ të merreshin kopjet e dokumentacionit të kërkuar që i nevojiteshin Komisionerit, u ra dakort që të niseshin nga ana e z. Sh në mënyrë shkresore, me anë të shërbimit postar.

Kështu, me anë të shkresës me nr. 73 Prot., datë 10.10.2014, nga ana e Sektorit të Profilaksisë dhe Mjekimit, u dërgua një kopje e:

- Rregullores “Normat dhe Kriteret Fizike dhe Shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit”, nr. 1244, datë 07.07.2006.
- Vendimit të Komisionit Mjekësor për znj. B.

7. Komisioneri⁷ ngarkoi strukturat përkatëse të institucionit për kryerjen e një studimi, qëllimi i të cilit ishte kryerja e një procesi krahasimor ndërmjet vendeve të ndryshme europiane, lidhur me parashikimet që përmbanin aktet nënligjore përkatëse mbi kriteret mjekësore të përcaktuara për rekrutimin e studentëve në akademitë analoge me Akademinë e Sigurisë Shqiptare.

⁵Nga këto, 24 aplikantë janë meshkuj, 14 aplikante janë femra.

⁶Për arsye se z. Shehaj pohoi se nuk punonte fotokopja.

⁷ Vendimi nr.6, datë 14.01.2016 i Komisionerit.

Mbështetur në përfundimet e këtij studimi dhe informacioni i marrë nga dhjetë shtete anëtare⁸ të Equinet-it, ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është anëtar, rezulton se të gjithë shtetet që kanë dërguar informacion kanë parashikuar kritere specifike shëndetësore/mjekësore për kandidatët që do të rekrutohen nga Institucionet Arsimore respektive të edukimit policor. Vende të ndryshme kanë vendosur kritere të ndryshme mjekësore, lidhur me procesin e rekrutimit/skualifikimit të studentëve në institucionet mësimore të formimit policor. Njëri prej këtyre kritereve specifike është pikërisht edhe rasti i të paturit të shenjave të dukshme në lëkurë, fakt që e skualifikonte konkurrentin.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të pretenduar nga ankuesja:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” është një akt nënligjor, i cili ka si qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të Policisë së Shtetit, përcaktimin e parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të punonjësit të Policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit, përcaktimin e ecures në karrierë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, vlerësimin të performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe rregullave për disiplinën dhe procedurave që ndiqen në rastin e shkeljeve disiplinore.

Në kreun II të saj, Rregullorja e Policisë së Shtetit parashikon procedurat e pranimit në Akademinë e Sigurisë. Në nenin 135 të kësaj Rregulloreje parashikohet:

“1. Aplikanti që kualifikohet për të vazhduar procesin e pranimit në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet fazave të konkurrimit sipas rendit të mëposhtëm:

- a) testimit me shkrim;*
- b) testimit të aftësive fizike;*
- c) intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese dhe testimit të aftësive të shkruarit;*
- ç) testimit psikologjik;*
- d) kontrollit shëndetësor;**
- dh) marrjes së shenjave të gishtave;*
- e) verifikimi përfundimtar i aplikantit.*

⁸ Bëhet fjalë për Lituanië, Greqinë, Hungarinë, Sllovakinë, Italinë, Kroacinë, Letoninë, Gjermaninë, Belgjikën dhe Republikën Çeke.

2. Drejtori i Policisë së Shtetit përcakton rregullat e testimit, kufirin minimal të pikëve, si dhe peshën specifike që do të ketë secili prej testeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, në raport me rezultatin e përgjithshëm të aplikantit”.

Për sa më sipër, rezulton se aplikanti, i cili konkuron për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë, i nënshtrohet disa fazave të konkurrencës, të cilat janë renditur dhe kryhen sipas një rradhe të caktuar, të përcaktuar shprehimisht në nenin 135, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, ku kontrolli shëndetësor kryhet pas kryerjes së testimit me shkrim, testimit të aftësive fizike, intervistës me gojë, ushtrimeve vlerësuese e testimit të aftësive të shkruarit dhe testimit psikologjik të aplikantit.

Referuar nenit 136, pika 3, gërma a), të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, struktura përgjegjëse për kryerjen e kontrollit shëndetësor, është Komisioni i Kontrollit Shëndetësor. Në nenin 137 të VKM-së së mësipërme parashikohet se aplikanti i nënshtrohet kontrollit dhe ekzaminimeve mjekësore pas përfundimit të procesit të testimit. Llojet e vizitave, ekzaminimeve, si dhe rregullat e kryerjes së tyre, përcaktohen në procedurat standarde, të miratuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit. Procesi i ekzaminimeve mjekësore të aplikantëve, menaxhohet nga Komisioni për Kontrollin Shëndetësor. Për ekzaminime të veçanta, Komisioni vendos për institucionin shëndetësor, ku do të kryhet ekzaminimi. Realizimi i kontrolleve dhe ekzaminimeve mjekësore, bëhet sipas marrëveshjes midis Policisë së Shtetit dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm, të Kujdesit Shëndetësor.

Referuar sa më sipër, znj.A. B ka kaluar me sukses testimin me shkrim, testimin e aftësive fizike, intervistën me gojë, ushtrimet vlerësuese e testimin e aftësive të shkruarit, si dhe testimin psikologjik. Në fazën pasardhëse, pikërisht gjatë kontrollit shëndetësor, ajo rezultoi e “paaftë”, pikërisht për shkak të “çikatriçeve” në fytyrë, diagnostifikuar si “Hyperpigmentin i trashëguar”. Referuar nenit 6, pika 2⁹ të Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit”, të gjithë aplikantët, të cilët rezultojnë në përfundim të kontrollit mjekësor të jenë të “paaftë”, nuk pranohen në Akademinë e Sigurisë.

Si rrjedhim, në mbështetje të nenit 140, pika 2¹⁰, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, znj.A. B është skualifikuar.

⁹Neni 12 i Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit” parashikon :

⁹Neni 6, përcakton se: “Lëkura dhe flokët e aplikantëve për ekzaminime nuk duhet të paraqesin problem, të mos kenë cikatrice, njolla apo përbërje tumoriale që i përkasin lëkurës dhe janë të dukshme”.

¹⁰Neni 140, pika 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” parashikon: “Aplikanti në rast se nuk kalon një nga fazat e konkurrencës, sipas rendit të

Nga verifikimi i Listës së aplikantëve pjesëmarrës në konkurrimin për Shkollën Bazë të Policisë “Patrullë e Përgjithshme”, për periudhën 09 Qershor – 08 Korrik 2014, lidhur me rezultatet e vlerësimit të aftësive shëndetësore, rezultojnë se nga 593 (pesëqind e nëntëdhjetë e tre) aplikantë gjithsej, 38 (tridhjetë e tetë) prej tyre janë të “pa aftë”¹¹, si rezultat i vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Aftësive Shëndetësore.

Në këto kushte, rezulton se janë zbatuar parashikimet përkatëse të akteve nënligjore të sipërpërmendura, lidhur me procedurat e pranimit dhe skualifikimit të konkurrenteve.

Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.*

Në këtë kontekst, vlerësohet se znj.B nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, krahasuar me persona apo grupe personash në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, pasi të gjithë konkurentët që nuk kanë plotësuar kriteret mjekësore të përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse janë skualifikuar.

B. Shkaqet e diskriminimit të pretenduara nga ankuesja.

Ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të gjendjes shëndetësore, për shkak të predispozicionit gjenetik të saj.

*“Gjendja shëndetësore” dhe “Përkatësia në një grup të veçantë” janë shkaqe, për të cilat Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

përcaktuar në nenin 135 të kësaj rregulloreje, humbet të drejtën për kalimin në fazën tjetër të konkurimit dhe skualifikohet”.

¹¹Nga këto, 24 aplikantë janë meshkuj, 14 aplikante janë femra.

Nga analizimi në tërësi i fakteve dhe provave të administruara përgjatë procesit të hetimit administrativ rezulton se janë zbatuar dispozitat përkatëse të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” dhe Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e rregullores “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit”” mbi ndjekjen e procedurave të konkurimit për rekrutimin e studentëve të rinj, si dhe për skualifikimin e tyre në rast mos plotësimi të kriterëve përkatëse, ndër të cilat edhe ato mjekësore.

Përgjatë procesit të shqyrtimit të çështjes rezultoi se në konkursin e zhvilluar në vitin 2014 për pranimin e studentëve të rinj pranë Akademisë së Sigurisë, janë skualifikuar 38 konkurentë, ndërmjet të cilëve edhe ankuesja, të cilët pas ekzaminimit mjekësor kanë rezultuar “të paaftë”.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ndaj ankueses nuk është ndërmarrë asnjë veprim apo mosveprim nga Akademia e Sigurisë, që të ketë krijuar baza për mohimin e barazisë ndaj saj, ose që ta kenë ekspozuar atë ndaj një trajtimi të ndryshëm, kur është ndodhur në rrethana të njëjta ose të ngjashme, me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të akteve nënligjore të sipërpërmendura, të gjithë konkurentët që pas ekzaminimit mjekësor janë skualifikuar si të paaftë, janë skualifikuar përfundimisht, pavarësisht se ata kanë rezultuar fitues në fazat e mëparshme të konkurimit. Duke qene se kriteret mjekësore për pranimin në Akademinë e Sigurisë, duhen konsideruar njëjloj si kriteret e tjera që janë përcaktuar në aktet përkatëse, mosplotësimi i tyre pasjell skualifikimin e konkurentëve.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore apo të predispozicionit gjenetik.

Për sa i përket pretendimit të ankueses, se ajo duhej të ishte njoftuar më parë nga strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë, lidhur me faktin se kontrolli shëndetësor ishte fazë e mëpasshme nga testimet e tjera, për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë dhe se mos kalimi i kësaj faze do të sillte rrjedhimisht skualifikimin e saj, Komisioneri gjykon se procedurat e pranimit në Akademinë e Sigurisë janë të parashikuara shprehimisht në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, i cili është një akt nënligjor që mund të disponohet nga cilido, që është i interesuar për t’u informuar mbi fazat e konkurimit pranë Akademisë së Sigurisë.

C. Lidhur me justifikimin e subjektit ndaj të cilëve drejtohet ankesa, Komisioneri gjykon se:

Procedurat e konkurimit dhe skualifikimi i konkurentëve që nuk plotësonin kriteret, si ato fizike, edhe ato mjekësore etj, është kryer në zbatim në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.9.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit” dhe Urdhërit nr. 1244, datë

07.07.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për miratimin e rregullore “Normat dhe kriteret fizike-shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit””.

Në kushtet kur aktet e sipërpërmendura parashikojnë me hollësi fazat e mënyrën e konkurimit, si dhe kriteret fizike, mjekësore etj. të cilat duhen plotësuar nga konkurentët për t’u pranuar në Akademinë e Policisë, përzgjedhja dhe skualifikimi i tyre është kryer konform këtyre parashikimeve.

Znj.B është cilësuar “e paaftë për Akademinë e Policisë” nga ana e Komisionit për Kontrollin Shëndetësor, i cili është mbështetur në rezultatet e analizave laboratorike, ku ankuesja ka rezultuar me hyperpigmentin të trashëguar. Në bazë të pikës 2, të nenit 6, të Urdhërit nr. 1244, datë 07.07.2006 “Për miratimin e rregullore “Normat dhe kriteret fizike – shëndetësore për punonjësit e Policisë së Shtetit” parashikohet se: “Lëkura dhe flokët e aplikantëve per rekrutim nuk duhet të paraqesin problem, të mos kenë cicatrice, njolla apo përbërje tumori që i përkasin lëkurës dhe janë të dukshme”.

Pavarësisht sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u ndal më gjatë për shqyrtimin e çështjes së znj.B, pasi pavarësisht se Akademia e Policisë ka ndjekur parashikimet në aktet përkatëse nënligjore, a janë në vetvete këto parashikime diskriminuese për sa i përket kriterit të vendosur për skualifikimin e konkurentëve që diagnostifikohen me njolla në lëkurë?!

Komisioneri shqyrtimin e ankesës së znj.B, ngarkoi strukturat e tij përkatëse për kryerjen e një studimi, qëllimi i të cilit ishte kryerja e një procesi krahasimor ndërmjet vendeve të ndryshme europiane, lidhur me parashikimet që përmbanin aktet nënligjore përkatëse mbi kriteret mjekësore të përcaktuara për rekrutimin e studentëve në akademitë analoge me Akademinë e Policisë Shqiptare.

Mbështetur në përfundimet e këtij studimi dhe informacioni i marrë nga dhjetë shtete anëtare¹² të Equinet-it, ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është anëtar, rezulton se të gjithë shtetet që kanë dërguar informacion kanë parashikuar kriteret specifike shëndetësore/mjekësore për kandidatët që do të rekrutohen nga Institucionet Arsimore respektive të edukimit policor.

Vende të ndryshme kanë vendosur kriteret të ndryshme mjekësore, lidhur me procesin e rekrutimit/skualifikimit të studentëve në institucionet mësimore të formimit policor.

Njëri prej këtyre kriterëve specifike është pikërisht edhe rasti i të qënurit i diagnostifikuar me njolla në lëkurë apo shenja që janë të dukshme, fakt që e skualifikonte konkurentin.

PËR KËTO ARSYE :

¹² Bëhet fjalë për Lituaninë, Greqinë, Hungarinë, Sllovakinë, Italinë, Kroacinë, Letoninë, Gjermaninë, Belgjikën dhe Republikën Çeke.

Mbështetur nenet 1, 2, 3, pika 1, neni 4, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 17, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 e 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të predispozicionit gjenetik, të znj.A. B, nga ana e Akademisë së Policisë Shqiptare.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: predispozicioni gjenetik)

(fusha: arsim)